STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 19 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON TRENIN FALAS TE METROSE PERGJATE GADISHULLIT ROKEUEJ (ROCKAWAY)

Treni H zëvendëson një pjesë të linjës A të goditur nga stuhia

MTA sjell trena në Rokeuejs (Rockaways) me kamiona për të përmirësuar opsionet e tranzitit

Fotografi dhe video të disponueshme të operacionit të ngritjes së trenit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se banorët e Gadishullit Rokëuej (Rockaway) do të jenë në gjendje të përdorin një shërbim të trenit falas duke filluar në 4 të mëngjesit të martën, 20 nëntor. Autoriteti i Transportit Metropolitan (MTA) do të vërë në funksionim shërbimin duke përdorur vagona të metrosë që u sollën me kamiona në Rokëuejs (Rockaways) pasi shinat që i lidhnin ato me pjesën tjetër të Kuins (Queens) u dëmtuan nga Uragani Sendi (Sandy).

Treni i ri i quajtur H do të funksionojë çdo 15 minuta ndërmjet stacionit Far Rockaway-Mott Avenue dhe stacionit Beach 90-Holland, duke bërë të gjitha ndalesat e ndërmjetme duke përdorur një lidhje të njohur si Hammels Wye që zakonisht nuk përdoret për shërbim. Stacionet në perëndim të Beach 90-Holland pësuan dëm të gjerë të sistemeve të sinjalit dhe nuk mund të përdoren ende për shërbimin e pasagjerëve.

Treni H do të shkojë ndërmjet 4 të mëngjesit dhe 1 të mëngjesit, duke lënë kohë për mirëmbajtjen dhe inspektimin e linjës gjatë natës. Udhëtarët e Rokëuejs (Rockaway) që marrin H për në stacionin Far Rockaway-Mott Avenue mund të përdorin autobusin falas që atje në stacionin Howard Beach në trenin A, duke i lidhur ata me pjesën tjetër të sistemit të metrosë të Tranzitit të Qytetit të Nju Jorkut të MTA-së.

“Shinat e trenit A nga Hauërd Biç (Howard Beach) në Rokëuejs (Rockaways) pothuajse ishin shkatërruar plotësisht nga stuhia dhe zëvendësimi i tyre është një sipërmarrje e jashtëzakonshme,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ndërsa ajo punë vazhdon, ky shërbimi i ri i trenit do të ndihmojë në përmirësimin e udhëtimit për njerëzit në Rokëuejs (Rockaways) që ende janë duke u rimëkëmbur nga pasojat e Sendit (Sandy).”

Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut i MTA-së krijoi shërbimin e ri të trenit H duke ngarkuar 20 vagona R-32 të metrosë në kamiona të sheshtë në Ozone Park, Kuins (Queens), duke i ngarë ata mbi Urën e Përkujtimores së Veteranëve Cross Bay të Urave dhe Tuneleve të MTA-së dhe duke i vendosur ata përsëri në shina në stacionin Rockaway Park-Beach 116.

Secili vagon është 60 këmbë i gjatë dhe peshon 80,000 paund. Operacioni i transferimit u krye gjatë katër netëve. Fotografi të operacionit të transferimit janë të disponueshme në http://flic.kr/s/aHsjCRHC7X dhe video e papërpunuar e përshtatshme për transmetim është e disponueshme në http://youtu.be/MwminkbnAn0.

"Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut i MTA-së është përgjigjur me krijueshmëri të pashembullt për të rivendosur shërbimin e metrosë për udhëtarët e Rokëuej (Rockaway)," tha Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota). "Kjo rivendosje e pjesshme e shërbimit është një hap i rëndësishëm për Rokëuejs (Rockaways), por puna jonë nuk do të përfundojë derisa treni A të jetë rivendosur plotësisht."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418